

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Blerje Pesticide

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

24451000-0

VLERA E FONDIT LIMIT:

2.490.000 (dy milion e katerqind e nentedhete mije) lekë pa Tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Ndermarrja e Shwerbimeve Komunale Durres ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formulari i ofertës ekonomike sipas Shtojcës 1*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, nenit 27, 28 ,29, 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

NR	EMERTIMI I LENDES AKTIVE	SPECIFIKIME TEKNIKE
1	Insekticid piretroid i tretshem ne uje per insektet fluturuese dhe zvarritese (Biocid) - Cypermethrine 10% ose Insekticid – per perdorim ne shendetin publik kunder insekteve fluturuese me lende active ekuivalente, pjese te listes se VKM Nr.933 dt 25.22.2020, me % jo me te larte se 10%	Gjendja fizike i lengshem. Ambalazhi do jete ne shishe 50-100 ml ose ne shishe me nje sasi lengu qe tretet ne jo me shume se 20 litra uje
2	Insekticid pluhur per insektet zvarritese (Biocid) – per perdorim ne shendetin publik pluhur i gatshem per perdorim lende active 100% e paster pa bashke formulues te tjere kimike, pjese te listes se VKM Nr.933 dt 25.22.2020	Gjendja fizike pluhur i gatshem per perdorim. Ambalazhi do jete ne shishe ose qese alumini 50-200 .gr
3	Rodenticid- Bromadiolone 0,005% ose rodenticid per perdorim ne shendetin publik me nje lende active ekuivalente te gjenerates se II te antikoagulanteve, pjese te listes se VKM Nr.933 dt 25.22.2020, me % jo me te larte se 0,005%	Gjendja fizike-llokum/Block. Ambalazh qese 20 gram deri 250 gr
4	Herbicid - Glyphosate 36% ose herbicid total ne % ekuivalente	Gjendja fizike I lengshem. Ambalazhi do jete shishe 1Lt

1- Insekticid i tretshem ne uje per insektet fluturuese dhe zvarritese (Biocid)- Cypermethrine 10% ose Insekticid – per perdorim ne shendetin publik kunder insekteve fluturuese me lende active ekuivalente, pjese te listes se VKM Nr.933 dt 25.22.2020, me % jo me te larte se 10% . Gjendja fizike i lengshem. Ambalazhi do jete ne shishe 50-100 ml ose ne shishe me nje sasi lengu qe tretet ne jo me shume se 20 litra uje.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 4,pika 38 si dhe nenin 36,pika 2 dhe 3 të ligjit nr.162/2020. Hartimi i specifikimeve teknike është kryer nga punonjësit e oficinës se NSHK Durres duke iu referuar kërkesave dhe nevojave të autoritetit kontraktor NSHK Durres në fushën e veprimtarisë së tij. Cypermetrina eshte dhe lende aktive qe perdoret ne fushen e bujqesise me % te larte (Referuar Lista E Pmb-Ve Të Regjistruara Për T'u Importuar Dhe Tregtuar Në Republikën E Shqipërisë/maj 2024), kemi vendosur kete kufi % per te qartesuar ofertuesit se do te pranohen vetem ato produkte per perdorim ne fushen e shendetit publik dhe jo produktet me po kete lende aktive por qe destinacion kane perdorimin ne fushen e bujqesise pasi nese do perdoren ne fushen e shendetit publik me % te larte insektet do te krijojne rezistence ndaj ketyre lendeve dhe ne te ardhmen nuk do te kene me asnje efekt ne perdorim. Ky eshte nje nga kriteret baze per ndarjen e perdorimit te produkteve ne sektorin e shendetit publik.

Produktet e kerkuara jane te rendesishme ne ushrimin e detyrave funksionale te Autoritetit Kontraktor. Keto produkte garantojne marrjen e masave efikase per parandalimin e infeksioneve nga demtuesit ne shendetin publik, sipas detyrimeve te percaktuara ne legjislacionin ne fuqi.

Per paketimet eshte percaktuar nje diapason nga 50 deri ne 100 ml, ose nje sasi lengu e tretshme ne jo me shum ese 20 litra uje.Produktet biocide dhe pesticide jane produkte helmuese te cilat

duhet te magazinohet ne paketimin e tyre te posaçme per shkak te toksicitetit. Duke qene se pas hapjes nga paketimi I tij origjinal , produkti duhet te perdoret dhe nuk mund te mbyllet pasi kushtet e ruajtjes nuk do te jene me te njejta pasi I mungojne elementet e sigurise, ne kete rast ngjitja me alumin e cila shmang derdhjet aksidentale ne mjedis, kerkojme paketime te cilat mund ti perdorim vetem nje here. Theksojme se kemi objekte ne te cilat do te perdoren keto preparate per kryerjen e sherbimeve qe jane siperfaqe shume te vogla. Hapja dhe ri-mbyllja e paketimit origjinal, per shkak se produkti do te ekspozohet ndaj agjenteve atmosferik, ndikon ne cilesine e tij dhe per pasoje ne cilesine e sherbimit qe do te kryhet me te . Gjithashtu, hapja dhe ri mbyllja e paketimit origjinal per tu ri-perdorur, ka rrezikun potencial per te avulluar ne mjedis duke shaktuar avuj toksik dhe rrezikun potencial per tu derdhur ne mjedis. Duke qene se pompat per sperkatje qe disponojme ne si AK me te cilat do te kryhet trajtimi ne ambjente te ndryshme kane kapacitet deri ne 20 litra uje. Mallrat e kerkuar duhet te tretien ne uje per tu perdorur, sa me e madhe te jete sasia ne ml aq me madhe eshte sasia e ujit qe do te tretien. Kemi te bejme me produkte te cilat konsiderohen te rrezikshme dhe derdhja ne ambjent e tyre ,aq me teper ne perqendrimin qe kane ne paketimin origjinal, shkakton helmim per njerezit, kafshet dhe organizmat ujore.

AK e realizon kete procedure prej shume vitesh, dhe paketimet e medha kane shaktuar problem ne ambjentin e punes pasi ka pasur raste qe ka pasur rrjedhje dhe derdhjet e paketimeve te hapura duke shaktuar konfuzion per punonjesit e ndermarrjes dhe arome te rende pasi ambjenti ku magazinohen keto produkte eshte ne te njejten ndertese me zyrat e administrates.

Nje arsye tjeter pse AK kerkon paketime te vogla jane rastet kurt rajtimi me keto produkte behet ne ambjentete vogla te cilat kerkojne me pak se 20 litra uje tresetire. Ne keto raste punetori i sherbimit duhet te ktheje ne magazine sasine e mbetur te produktin, por eshte e pamundur per magazinën te beje hyrjes sasine e mbetur apo dalje aq sasi produkti sa do ti duhet punonjesit te sherbimit per te kryer sherbimin, pasi kemi te bejme me produkte helmuese te cilat duhet te magazinohet ne paketimin e tyre te posaçme per shkak te toksicitetit.

Paketimet e vogla jane domosdoshmeri per AK per arsye se ne nuk disponojme pajisje me depozita me te medha se 20 litra dhe kjo eshte e vetmja menyre per te shmangur derdhjen e produkteve te perqendruara ne mjedis, shmangur raste e helmimit, apo per te kontrolluar gjendjen e magazines.

2- Insekticid pluhur per insektet zvarritese (Biocid) – per perdorim ne shendetin publik pluhur i gatshem per perdorim lende active 100% e paster pa bashke formulues te tjere kimike, pjese te listes se VKM Nr.933 dt 25.22.2020. Gjendja fizike pluhur i gatshem per perdorim. Ambalazhi do jete ne shishe ose qese alumini 50-100 gr.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 4,pika 38 si dhe nenin 36,pika 2 dhe 3 të ligjit nr.162/2020. Hartimi i specifikimeve teknike është kryer nga punonjësit e oficinës së NSHK Durres duke iu referuar kërkesave dhe nevojave të autoritetit kontraktor NSHK Durres në fushën e veprimtarisë së tij.

Produktet e kerkuara jane te rendesishme ne ushtrimin e detyrave funksionale te Autoritetit Kontraktor. Keto produkte garantojne marrjen e masave efikase per parandalimin e infeksioneve nga demtuesit ne shendetin publik, sipas detyrimeve te percaktuara ne legjislacionin ne fuqi.

Problem është shfaqja e insekteve zvarritese ne ambientet e cerdheve dhe kopshteve ku ka femije qe jane ne kontakt te drejtperdrejte me siperfaqet ku trajtohet me insekticide piretroide. Perdorimi i preparateve natyrale pa permbajtje piretroide dhe bashke formulues te tjere kimike eshte i domosdoshem per te shmangur problemet me irritimin e lekures se femijeve te cerdeheve dhe kopshteve. Sipas percaktimeve ne etiketen e preparateve me permbajtje piretoride, ato mund te shkaktojne parestezi. Keto produkte lene mbetje ne mjedis, dhe efektinegativ i tyre tek femijet mund te shfaqet edhe disa dite pas trajtimit me keto preparate. Per te shmangur problemet shendetesore ne keto mjedise sensitive, eshte i domosdoshem perdorimi i preparateve biocide natyrale.

Shfaqja e insekteve zvarritese, kryesisht buburrecat e zinj, ndikuar nga lageshtia ajrore, eshte nje nga problematikat me te shfaqura ne ambientet e cerdheve dhe kopshteve. Ky problem eshte i njejte cdo vit. Luftimi i tyre ne ambiente specifike me insekticide te tretshme ne uje dhe me sperkatje ka qene i pamundur per shkak te rezistences qe kane shfaqur. Per kete arsye eshte i domosdoshem perdorimi i nje insekticidi pluhur natyral qe qendron me teper ne mjedis, dhe duke qene me permbajtje natyrale nuk le mbetje ne mjedisin qe do aplikohet pas pastrimit manual. Percaktimi i gjendjes fizike dhe natyres se produktit biocid te kerkuar, me lende pjese e VKM Nr.933 dt 25.22.2020, eshte e lidhur me kerkesat funksionale dhe natyren e sherbimit qe do kryhet me kete produkt.

Per paketimet eshte percaktuar nje diapason nga 50 deri ne 200 gr.

Duke qene se pas hapjes nga paketimi I tij origjinal , produkti duhet te perdoret dhe nuk mund te mbyllet pasi kushtet e ruajtjes nuk do te jene me te njejta pasi I mungojne elementet e sigurise, ne kete rast ngjitja me alumin e cila shmang derdhjet aksidentale ne mjedis, kerkojme paketime te cilat mund ti perdorim vetem nje here.Theksojme se kemi objekte ne te cilat do te perdoren keto preparate per kryerjen e sherbimeve qe jane siperfaqe shume te vogla. Hapja dhe ri-mbyllja e paketimit origjinal, per shkak se produkti do te ekspozohet ndaj agjenteve atmosferik, ndikon ne cilesine e tij dhe per pasoje ne cilesine e sherbimit qe do te kryhet me te . Gjithashtu, hapja dhe ri mbyllja e paketimit origjinal per tu ri-perdorur, ka rrezikun potencial per te avulluar ne mjedis duke shaktuar avuj toksik dhe rrezikun potencial per tu derdhur ne mjedis.

3- Rodenticid- Bromadiolone 0,005% ose rodenticid per perdorim ne shendetin publik me nje lende active ekuivalente te gjenerates se II te antikoagulanteve, pjese te listes se VKM Nr.933 dt 25.22.2020, me % jo me te larte se 0,005% . Gjendja fizike-llokum/Block. Ambalazh qese 20 gram deri 250 gr

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 4,pika 38 si dhe nenin 36,pika 2 dhe 3 të ligjit nr.162/2020. Hartimi i specifikimeve teknike është kryer nga punonjësit e oficinës se NSHK Durres duke iu referuar kërkesave dhe nevojave të autoritetit kontraktor NSHK Durres në fushën e veprimtarisë së tij.

Produktet e kerkuara jane te rendesishme ne ushrimin e detyrave funksionale te Autoritetit Kontraktor. Keto produkte garantojne marrjen e masave efikase per parandalimin e infeksioneve nga demtuesit ne shendetin publik, sipas detyrimeve te percaktuara ne legjislacionin ne fuqi. Per paketimet eshte percaktuar nje diapason nga 50 deri ne 250 gr.

Duke qene se pas hapjes nga paketimi I tij origjinal , produkti duhet te perdoret dhe nuk mund te

mbyllet pasi kushtet e ruajtjes nuk do te jene me te njejta pasi i mungojne elementet e sigurise, ne kete rast ngjitja, e cila shmang derdhjet aksidentale ne mjedis, kerkojme paketime te cilat mund ti perdorim vetem nje here. Theksojme se kemi objekte ne te cilat do te perdoren keto preparate per kryerjen e sherbimeve qe jane siperfaqe shume te vogla. Hapja dhe ri-mbyllja e paketimit origjinal, per shkak se produkti do te ekspozohet ndaj agjenteve atmosferik, ndikon ne cilesine e tij dhe per pasoje ne cilesine e sherbimit qe do te kryhet me te . Gjithashtu, hapja dhe ri mbyllja e paketimit origjinal per tu ri-perdorur, ka rrezikun potencial per te avulluar ne mjedis duke shaktuar avuj toksik dhe rrezikun potencial per tu derdhur ne mjedis.

4- **Herbicid** - Glyphosate 36ose herbicid total ne % ekuivalente. Gjendja fizike I lengshem. Ambalazhi do jete shishe 500 ml- 1Lt.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 4,pika 38 si dhe nenin 36,pika 2 dhe 3 të ligjit nr.162/2020. Hartimi i specifikimeve teknike është kryer nga punonjësit e oficinës se NSHK Durres duke iu referuar kërkesave dhe nevojave të autoritetit kontraktor NSHK Durres në fushën e veprimtarisë së tij.

Produktet e kerkuara jane te rendesishme ne ushrimin e detyrave funksionale te Autoritetit Kontraktor. Keto produkte garantojne marrjen e masave efikase per parandalimin e infeksioneve nga demtuesit ne shendetin publik, sipas detyrimeve te percaktuara ne legjislacionin ne fuqi. Per paketimet eshte percaktuar nje diapason nga 500 ml deri ne 1 liter.

Glyphosate 36 % eshte herbicid total, jo herbicid selektiv. Duke qene se pas hapjes nga paketimi I tij origjinal , produkti duhet te perdoret dhe nuk mund te mbyllet pasi kushtet e ruajtjes nuk do te jene me te njejta pasi i mungojne elementet e sigurise, ne kete rast ngjitja, e cila shmang derdhjet aksidentale ne mjedis, kerkojme paketime te cilat mund ti perdorim vetem nje here. Siperfaqet qe trajtohen me Herbicid , kerkojne doza te caktuara dhe paketimet me te medha do te shfaqin rrezik per jeten e punonjesve dhe derdhjen ne mjedis. Hapja dhe ri-mbyllja e paketimit origjinal, per shkak se produkti do te ekspozohet ndaj agjenteve atmosferik, ndikon ne cilesine e tij dhe per pasoje ne cilesine e sherbimit qe do te kryhet me te . Gjithashtu, hapja dhe ri mbyllja e paketimit origjinal per tu ri-perdorur, ka rrezikun potencial per te avulluar ne mjedis duke shaktuar avuj toksik dhe rrezikun potencial per tu derdhur ne mjedis.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë plotësohet nëpërmjet dorëzimit të Shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

(Shënim: *përcaktoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit*).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në përcaktimin e vlerës së xhiros vjetore autoriteti kontraktor i është referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Seksionit III, Neni 43 pika 2, gërma (b).

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022,2023 ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit.**

Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” nenit 40 pika 4 ku është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Operatori ekonomik ofertues te paraqese certifikatat qe vërteton se sistemi I kontrollit të cilësisë së ofertuesit është sipas standartit.

2.3.2 Çertifikate personale ISO 9001:2015, te standartit nderkombetar te menaxhimit te cilesise dhe /ose te njevlefshme, te cilat do te garantonin cilesine e produktit ose standart

ISO me e avancuar, ku te jete i percaktuar objekti i prokurimit (e perkthyer e noterizuar). Çertifikatat duhet te jene te vlefshme dhe te leshuar nga organizma te vleresimit te konformitetit, te cilet jane akredituar nga DPA ose nga organizmat ndërkombetar akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së.

- 2.3.3 Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit OHSAS 18001-2007 / ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo certifikatë është kërkuar me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ne pune. Kodi i Punes dhe kuadri ligjor që rregullon tregtimin dhe përdorimin e produkteve biocide i kushton një rëndësi parësore mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë ne pune. Ky çertifikim ofron një kuadër praktik për shoqëritë që menaxhojnë rreziqet ekzistuese dhe potenciale në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi dhe me Kodin e Punes Çertifikimi i operatorëve ekonomikë ofertues me Çertifikatën ISO 18001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të sigurose dhe shëndetit ne pune garanton autoritetin kontraktor për sigurinë e trajtimit të produkteve biocide në të gjithë zinxhirin e furnizimit nga burimi i furnizimit deri në destinacionin e kërkuar.

2.3.4 Çertifikate personale ISO 14001:2015, te standartit nderkombetar i menaxhimit te mjedisit dhe /ose te njevlefshme,ose standart ISO me e avancuar, ku te jete i percaktuar objekti i prokurimit (e perkthyer e noterizuar). Çertifikatat duhet te jene te vlefshme dhe te leshuar nga organizma te vleresimit te konformitetit, te cilet jane akredituar nga DPA ose nga organizmat nderkombetar akreditues të njohur nga Republika e Shqiperisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 pika 2 c) të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 7 pika ç), neni 17 pika a) e Ligjit nr.95/2015 datë 17.09.2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”, Ligjit nr.27/2017 datë 17.03.2016 “Për menaxhimin e kimikateve”, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.487, datë 29.6.2016 “Për klasifikimin e produkteve biocide”. Kjo certifikatë është kërkuar me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të mjedisit. Kuadri ligjor që rregullon tregtimin dhe përdorimin e produkteve biocide i kushton një rëndësi parësore mbrojtjes së mjedisit për vetë natyrën e rrezikshmërisë që mbartin këto produkte objekt prokurimi. Ky certifikim ofron një kuadër praktik për shoqëritë që menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. Çertifikimi i operatorëve ekonomikë ofertues me Çertifikatën ISO 14001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit garanton autoritetin kontraktor për sigurinë e trajtimit të produkteve biocide në të gjithë zinxhirin e furnizimit nga burimi i furnizimit deri në destinacionin e kërkuar.

2.3.5 OE Pjesemarres duhet te paraqese Certifikatat si me poshte:

- a) Çertifikate Regjistrimi nga Ministria e Bujqesise per produktet me perdorim bujqesor,te Autorizuesit

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosija e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi, Ligji 105/2016 Per Mbrojtjen e Bimeve (ndryshuar me ligjin nr.15/2022, datë 3.2.2022. , i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik kryen veprimtarine e tij profesionale ne pershtatshmeri me legjislacionin ne fuqi, licensa profesionale per per prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave objekt prokurimi, te leshuara nga organet kompetente shteterore.

- b) Autorizim te Ministrise se Shendetsise per importimin e lendeve te D.D.D,te Autorizuesit

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e

Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi. Ligji 95/2015 Per Vendosjen ne treg te produkteve Biocide, i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas standartit CE/ ose ekuivalent dhe direktivave lidhur si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se përmbushin kriteret ligjore për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Vendosja ne treg e produkteve biocide behet sipas percaktimeve ne Ligjin Nr.95/2015 Per Sherbimet dhe Produktet Biocide ne Shendetin Publik dhe VKM nr.933 date 25.11.2020 Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg” ne te cilen janë përcaktuar rregullat dhe kriteret për dhënien e autorizimit të vendosjes në treg të produkteve biocide..

Ne mungese te nje database per verifikimin e produkteve te autorizuar, eshte i domosdoshem paraqitja e autorizimit te vendosjes ne treg te produkteve biocide me qellim qe Autoriteti Kontraktor te kryeje verifikimet dhe te furnizohet me produkte te lejuara dhe autorizuar sipas legjislacionit.

c) Operatori ekonomik duhet te provojë që është i autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për këtë procedurë prokurimi (objekt, nr.REF) . Autorizimi i distributorit duhet te kete te percaktuar numrin e procedures dhe duhet te permbaje te dhena te plota si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij. Në rast paraqitje deklarate furnizimi/autorizim distributori, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument qe të vërtetohet lidhja midis Distributorit te Autorizuar dhe Prodhuesit

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri AK gjykon se deklarata e furnizimit ose autorizimi i prodhuesit /distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek Autoriteti Kontraktor të këtyre mallrave. Pra mallrat jane Autorizuar per tu vendosur ne treg sipas percaktimeve ne Ligjin nr 95/ 2015 dhe Ligjin nr 105/2016. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave objekt prokurimi të cilat kërkohen që të jenë prodhuar në përputhje me standardet dhe cilësitë e kërkuara në DST. Ky kriter është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë alternative (do të konsiderohen të barazvlefshme dhe deklaratat me shkrim të furnizimit dhe autorizimi i prodhuesit) i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

- d) Operatori ekonomik duhet te paraqesë Dokumentin e te dhënave të Sigurisë për të gjitha produktet, në gjuhën shqipe

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/ c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 13 dhe 15 të Ligjit Nr. 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”, VKM, nr. 9 datë 09.01.2019 “Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin dokumentin me të dhënat e sigurisë të cilat provojnë përmbushjen e karakteristikave teknike të mallrave objekt të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi me produkte biocide të cilat do të përdoren në objekte publik, shkollore dhe parashkollore, duhet të jenë konform specifikimeve teknike të kërkuara dhe kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, karakteristikat teknike të kërkuara. Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se është çmuar si e nevojshme që për garantimin e cilësisë së mallit nga vetë natyra e përdorimit është shumë e rëndësishme përmbushja e specifikimeve teknike pasi do të përdoren në ambiente që frekuentohen nga fëmijë të moshës 6 muajsh deri 18 vjeç dhe në ambientet ku zhvillohet aktiviteti mësimor. Ky dokument do tu vihet ne dispozicion edhe punonjësve të cilet do të kryejnë shërbimet me keto preparate, me qëllim që të njihen me masat e mbrojtjes personale gjatë përdorimit të tyre dhe rreziqet e tjera.

- e) License e Kodi II.8.B, Shërbime Nderhyrese Higjieno-Shëndetsore leshuar nga QKB.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; si dhe në zbatim të VKM nr.538 datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nepermjet qendres kombetare të licencimit dhe disa rregullime të tjera nenligjore të perbashketa”.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre të perkthyer. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

3.Operatori ekonomik ofertues duhet te garantoje kapacitetin transportues te mallrave si me poshte:

3.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër dërgimin e mallit në adresat e përcaktuara të AK-ve. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën.

3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë **të paktën 1 (nje) mjet transporti**, me qëllim transportin e mallrave, të cilët duhet t’i ketë në pronësi ose me qira.

Per sa me sipër operatori ekonomik të paraqes një deklaratë perkatese sipas formatit të mëposhtem:

Shenim 3.1:

Per mjetet me status perdorimi qira/hua perdorje te disponohet kontrata noteriale perkatese mes qiradhenesit dhe qiramarrsesit.

Për këtë mjet duhet të paraqesi librezë qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve.

Ne zbatim të ndryshimeve të reja ligjore Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacionin e mesipër pranë AK jo më vonë se 5 dite nga publikimi i njoftimit të fituesit perfundimtar

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të cilat janë të nevojshme për transportin e materialeve të pastrimit në adresat e të gjitha autoriteteve kontraktore . Në zbatim të pikës 1 dhe pikës 6 të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: *“1.Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, ku përcaktohet “6. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”*

Të dhënat që do të deklarohen, detyrimisht do të paraqiten Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës. Rastet e deklaratave të rreme, do të

konsiderohen kushte për skualifikim, si dhe do të ndiqet procedura për përjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar sipas standartit CE/ ose ekuivalent dhe direktivave lidhur si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

2.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë një automjet të pershtatshëm për transport të mallrave objekt prokurimi, për të cilin duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtem:

Aktin e pronësisë së mjetit përkatës;

Ose

Kontratën e marrjes me qira të mjetit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale.

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë (qoftë në pronësi apo dhe me qira) duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, taksat vjetore si dhe lejen e transportit për vete ose të trete për ato mjete që pajisen me leje transporti sipas legjislacionit në fuqi.

2.4.1 Deklarate nga Operatori Ekonomik që mer për sipër transportin e mallrave objekt prokurimi, në çdo kohë sipas kërkesave të AK në sasinë dhe cilësinë e këkuar.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.5 Operatori ekonomik ofertues, në ditën e hapjes së ofertave (përpara hapjes së tyre), pranë Autoritetit Kontraktor, pranë NSHK Durrës, duhet të paraqesë të protokolluara një mostër për secilin ze të mallrave objekt prokurimi, sipas listës së kërkuar:

NR	EMERTIMI I LENDES AKTIVE	Njesia	Sasia
1	Insekticid i tretshem ne uje per insektet fluturuese dhe zvarritese (Biocid) - Cypermethrine 10% ose Insekticid – per perdorim ne shendetin publik kunder insekteve fluturuese me lende active ekuivalente, pjese te listes se VKM Nr.933 dt 25.22.2020, me % jo me te larte se 10%	Lt	1
2	Insekticid pluhur per insektet zvarritese (Biocid) – per perdorim ne shendetin publik pluhur i gatshem per perdorim lende active 100% e paster pa bashke formulues te tjere kimike, pjese te listes se VKM Nr.933 dt 25.22.2020	Lt	1
3	Rodenticid- Bromadiolone 0,005% ose rodenticid per perdorim ne shendetin publik me nje lende active ekuivalente te gjenerates se II te antikoagulateve, pjese te listes se VKM Nr.933 dt 25.22.2020, me % jo me te larte se 0,005%	Kg	1
4	Herbicid - Glyphosate 36%	Lt	1

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 488, datë 29.6.2016 “Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.487 pika 7, datë 29.6.2016 “Për klasifikimin e produkteve biocide”, Udhëzimin nr. 3478 datë 05.05.2014 “Për etiketimin dhe ambalazhimin e produkteve biocide, dezinfektuese, dezinfektuese, deratizuese për përdorim në shëndetin publik”, të Ministrisë së Shëndetësisë. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave të kërkuara si mostra duke u nisur nga rëndësia që ato kanë për shkak të funksionalitetit special të tyre. Në këtë rast paraqitja e mostrave është konsideruar nga autoriteti kontraktor si e nevojshme pasi verifikimi fizik i tyre është gjykuar i rëndësishëm për të vlerësuar detyrimet ligjore të ambalazhimit dhe etiketimit të produkteve, sigurinë gjatë furnizimit së produkteve dhe sigurinë ndaj përdoruesve të tyre.

Shenim:

Referuar udhëzimeve të APP, për zerrat në DST që mund të jete paraqitur marke/brand, operatorët ekonomik mund të ofertojnë ekuivalente të tyre gjatë përgatitjes së ofertës ekonomike.

Shenim:

Mos dorezimi i informacionit të sakte apo dorezimi të rreme do të konsiderohet kusht për skualifikim dhe/ose fillim të hetimit administrativ për përjashtim të O.E. nga procedurat e prokurimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Hartimi i specifikimeve teknike është kryer nga punonjësit e oficinës së NSHK Durres duke iu referuar kërkesave dhe nevojave të autoritetit kontraktor NSHK Durres në fushën e veprimtarisë së tij.